



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:229109  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05427102

C.nr.325/18

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurit B.K nga fshati ... Komuna e Obiliqit, me objekt kontesti kompensim i dëmit, me vlerë të kontestit 427.95 euro, jashtë seance më datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET POSHTË padia me numër C. nr. 325/18 e datës 20.07.2018, për kompensimin e dëmit, e paditëses Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurit B.K nga fshati ... Komuna e Obiliqit, për shkak të mosdorëzimit të provave në ekzemplar të mjaftueshëm për palën e paditur.

A r s y e t i m

Paditësja Komuna e Vushtrrisë, me datë 20.07.2018, ka paraqitur padi për kompensim i dëmit në shumën prej 427.95 euro, kundër të paditurit B.K nga fshati ... Komuna e Obiliqit.

Gjykata me aktvendimin e datës 23.02.2024, e ka ftuar paditësen që në afat prej 3 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi, gjykatës t'ia dorëzojë edhe një ekzemplar të provave për palën e paditur, me paralajmërimin se gjykata do të merr aktvendim me të cilin do ta hedh poshtë padinë, në kuptim të dispozitës së nenit 102.3 dhe 102.4 të LPK-së.

Paditësja me datë 28.03.2024, e ka pranuar aktvendimin e datës 23.02.2024, por gjykatës nuk ia ka dorëzuar provat për palën e paditur.

Marr parasysh faktin se paditësja nuk ka vepruar sipas thirrjes së gjykatës për dorëzimin e provave, gjykata bazuar në të lartcekurat dhe konform nenit 102 par.3 dhe 102 par.4, lidhur me nenin 391 pika (g) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI**

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C. nr. 325/18, me datë 08.03.2024

Gj y q t a r i  
Jeton Zymeri

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit.